



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 506/10 prot

Datë 15.04.2026

V E N D I M

Nr. 503 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-62627-09-25-2025, me objekt “Realizimi dhe prodhimi i materialeve promocionale për promovimin e markës, shërbimeve postare - financiare dhe produkte filatelike”. me fond limit 5.000.000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Inpress” ShPK me *NIPT L52122014L*.
Adresa: Ish Blloku i Magazinave,, Rr. Siri Kodra, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Posta Shqiptare Sh.A
Adresa: Rr. “Reshit Çolloku”, Nr. 4, Tiranë.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” ShPK, *me Nipt K71903025A, Adresa: Rr. Shyqyri Bexolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020

“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi pretendimet e ngritura në ankesë, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.09.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-62627-09-25-2025, me objekt “Realizimi dhe prodhimi i materialeve promocionale për promovimin e markës, shërbimeve postare - financiare dhe produkte filatelike”, me fond limit 5.000.000 Lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare Sh.A.

II.2. Në datë 16.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 25.01.2026, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. Optima Communication ShPK me ofertë	3,750,000	Lekë pa TVSh	Kualifikuar
2. Inpress ShPK	“ 3,750,000	“	Kualifikuar
3. ALBDESIGN PSP ShPK	“ 4.600.700	“	Kualifikuar
4. DIXHI PRINT AL ShPK	“ 4,823,000	“	Skualifikuar
5. Kristalina ShPK	“ 0 lek	“	Skualifikuar
6. Filara ShPK	“ 0	“	Skualifikuar

II.4. Në datën 11.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6341, datë 17.02.2026 dhe me Nr. 506/2026 Prot., date 18.02.2026, nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-62627-09-25-2025, me objekt “Realizimi dhe prodhimi i materialeve promocionale për promovimin e markës, shërbimeve postare - financiare dhe produkte filatelike”. me fond limit 5.000.000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik Optima Communication ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 506/1 prot., datë 18.02.2026, lidhur me pretendimet e ankimuesit.

II.7. Nëpërmjet shkresës ardhur në Sistem, protokolluar me tonën me 506/2, datë 24.02.2026, operatori ekonomik, Optima Communication ShPK ka përcjellë Formular Argumente, në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1726/22 prot., datë 24.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 506/3, datë 25.02.2026, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke përcjellë Vendimin e KSHA-së mbi trajtimin e ankesës duke vendosur mospranimin e pretendimeve të ngritura për operatorin ekonomik Optima Communication ShPK.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 1726/23 prot., datë 27.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 506/4, datë 02.03.2026, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës ka informuar mbi hapat e zhvillimit të procedurës së prokurimit si edhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Inpress” ShPK.

II.10 Nëpërmjet shkresës me nr. 506/5 Prot., datë 05.03.2026, me objekt: Kërkesë për dorëzimin e mostrave dhe dokumentacion, Komisioni i Prokurimit Publik ndër të tjera shprehet:

[...]Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “*OPTIMA COMMUNICATION*” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar. Referuar Vendimit të KSHA-së, përcjellë pranë KPP-se, autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e pretendimeve të ankesës.

Referuar pretendimeve te ngritura në ankesë, në përputhje me nenin 26/6 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Në procedurat e prokurimit me një fazë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.” me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, kërkojmë nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese:

- Kopje të njehsuara me origjinalin të dokumentacionit provues të plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik **OPTIMA COMMUNICATION ShPK** i renditur i pari në këtë procedurë
- Mostrat objekt ankimi të paraqitura nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION ShPK. Konkretisht artikujt 1,5,6,9,17

Emërtimi i artikujve

1	Stilolaps me logo
5	Çantë e madhe kartoni
6	Çantë beze
9	Fletëpalosje (shërbime, histori, inovacion)
17	Korniza pecikllaz për vendosjen e posterave në formatin 50x70

Mostrat të shoqërohen së bashku me:

1. Dokumentacionin shoqërues si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre për të gjitha mostrat e dorëzuara si edhe

2. Dokumentacion mbi vlerësimin e kryer në përmbushje së specifikimeve teknike të mostrave të dorëzuara objekt ankimi. [...]

II.11. Nëpërmjet shkresës nr. 1726/25 prot., datë 11.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 506/6, datë 11.03.2026, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke përcjellë dokumentacionin provues, të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor si edhe mostrat e operatorit ekonomik Optima Communication ShPK.

II.12. Nëpërmjet shkresës me datë 11.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 506/7, datë 13.03.2026, operatori ekonomik i interesuar ka kërkuar nga AK që të vihet në dijeni për Vendimin e KSHA-së.

III

Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me ankesën e operatorit “Inpress” ShPK, me anë të së cilës kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik “Optima Communication” ShPK, mbi parregullsi të dokumentacionit të operatorit i kualifikuar i pari,

[...]Së **Pari**, Optima Communication, nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9 të DST, si dhe jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.1.a. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të shtojcës 8, të DST. Mendojmë se. ka përdorur tjetër formular vetëdeklarimi nga ai i publikuar nga autoriteti kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Formulari ka ndryshime si në formë por dhe në përmbajtje që është më e rëndësishmja, dhe rrjedhimisht OE Optima Communication shpk. nuk arrin të përmbushë kriteret e veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 2.1.a. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të DST.

Së **Dyti**, Ne kemi bindjen, që OE Optima Communication shpk. do të duhet të skualifikohet në zbatim të Nenit 76, pika 3/h, të ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, ku përcaktohet: h. operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.pasi, ky operator ekonomik nuk respekton dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Për sa mësipër, i kërkojmë KSHA së AK Posta Shqiptare sh.a. dhe KPP që përpara se të marrë një vendim në lidhje me ankesën objekt shqyrtimi, të bëjë verifikime të mëtejshme dhe ti kërkojë me shkrim informacion zyrtar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), nëse OE OPTIMA COMMUNICATION shpk. i respekton dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë,

III.1.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë vijon: **Shtojca 8**

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Shtojca 9 (Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT.

III.1.2. Operatori ekonomik ka paraqitur në SPE Dokumentet e ofertës së tij e konkretisht

Shtojca_9_formulari_i_vetedeklarimit_Posta_Promocionale.

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në pikat 1,2,5 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. **Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.**

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.5 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa dhe përsa kohë janë pranuar prej tyre.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori

*ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Nga verifikimi i dokumenteve standarde të publikuara nga autoriteti kontraktor konstatohet, se ky i fundit ka publikuar setin e dokumentave standarde për procedurën e prokurimit *Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*, sipas vendimit nr. 08, datë 05.10.2022, me ndryshimet përkatëse, konkretisht dhe të shtojcës 9 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, në të cilin konstatohen ndryshime thelbësore edhe në përmbajtje të tij.*

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e Kriteve të Përgjithshme të Përzgjedhjes / Kualifikimit si edhe Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK ka ngarkuar në SPE Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të plotësuar, nga verifikimi i të cilit konstatohen përputhje në formë edhe në përmbajtje me Shtojcën 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, publikuar në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK ka paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, të plotësuar në të gjitha seksionet në tërësi dhe në veçanti për pikat **e**, **dh**, dhe **k**, të Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit objekt ankimi nga operatori ekonomik. Formulari rezulton i firmosur edhe vulosur nga administratori i subjektit dhe ky formular rezulton i njejtë me formatin e ri me ndryshimet sipas vendimit sipërcituar, i njejtë me formularin e shtojcës 9, të DST-së.

Pretendimet e ankimuesit në lidhje me parregullsi të dokumentit, Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi mospërmbushje të Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit, me argumente:

[...]Operatori ekonomik Optima Communication shpk. nuk disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi,. Në pikën 2.3.2. Kapaciteti Teknik , të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST,duhet të paraqes dëshmi për stafin e punonjësve si dhe listëpagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë jo më i vogël se 5 (pesë) punonjës nga të cilët: -1 punonjës i diplomuar për designer grafik; Për punonjësit e stafit teknik, operatori ekonomik duhet të paraqes: Kontratën individuale të punës/kontrata bashkëpunimi dhe diploma/certifikime nga kompani/institucione të certifikuara. Ne kemi bindjen që OE OPTIMA COMMUNICATION shpk. nuk disponon personelin teknik të nevojshëm, referuar objektit të prokurimit, të kërkuar në DST. Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE OPTIMA COMMUNICATION shpk. nuk ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e nevojshëm ligjor, me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i stafit / personelit teknik designer grafik të kërkuar në DST, si dhe dokumentacioni plotësues i kërkuar në [...]

Me shkresën nr. 506/5 Prot., datë 05.03.2026, me objekt: Kërkesë për dorëzimin e mostrave dhe dokumentacionin provues të ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik ndër të tjera shprehet:

[...]Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e

operatorit ekonomik "OPTIMA COMMUNICATION" ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar. Referuar Vendimit të KSHA-së, përcjellë pranë KPP-se, autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e pretendimeve të ankesës.

Referuar pretendimeve të ngritura në ankesë, në përputhje me nenin 26/6 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Në procedurat e prokurimit me një fazë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij." me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, kërkojmë nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese:

- Kopje të njehsuara me origjinalin të dokumentacionit provues të plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik OPTIMA COMMUNICATION ShPK i renditur i pari në këtë procedurë

III.2.1. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 1726/25 prot, datë 11.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 506/6, datë 11.03.2026, përcolli pranë Komisionit, dokumentet provuese të cilat pasi i mori në shqyrtim konstaton, se janë paraqitur dokumentet si më poshtë vijon:

1. **Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit I plotësuar, firmosur dhe vulosur nga Administratori.**
2. **Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregëtar për të dhënat e Subjektit.**
3. **Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore, Min e Drejtësisë, Dr e Burgjeve, datë 14.01.2026. për Administratorin dhe Ortakun e Subjektit (2 dokumente).**
4. **Dokument nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Nr. 11 prot, datë 14.01.2026, Vërtetim për Subjektin OPTIMA COMMUNICATION është i padënuar.**
5. **Dokument, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë, Nr.T14876967. datë 15.01.2026. Vërtetim, për tatimpaguesin, rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datë 15.01.2026.**
6. **Dokument, Vërtetim, nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, për taksapaguesin OPTIMA COMMUNICATION, nr. 41245, Vërtetohet se subjekti ka likuiduar detyrimet vendore, data e marrjes 14.01.2026.**
7. **Deklaratë mbi Listapagesat të kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatime mbi të ardhurat për tre muaj.**

8. Dokument, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë, Nr.T14871871. datë 14.01.2026. Vërtetim, për Kontributet e Sig Shoqërore dhe Shëndetësore për Tatimpaguesin-E-Sig 02/a , rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datë 14.01.2026

9. Vërtetim Debie me nr.VD000024193, Datë 14.01.2026, për klientin OPTIMA COMMUNICATION ShPK, nuk rezulton debitor për energjinë elektrike pranë shoqërisë FSHU Sha.

III.2.2. Referuar, bazës ligjore, neni 26/6 i VKM-së 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Deklarimeve të Shtojcës 9 dhe Dokumentacionit provues të operatorit ekonomik, dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit, rezulton se operatori ekonomik Optima Communication ShPK, ka përcjellë pranë Autoritetit Kontraktor të gjitha dokumentet provuese, të cilat i ka deklaruar me shtojcën 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, në përmbushje të Kritereve të Përgjithshme Kualifikues.

Nga verifikimet e kryera nga Komisioni, bazuar mbi pretendimet e ngritura nga ankimuesi për mangësi të dokumenteve provuese për pikat **dh)** **e)** dhe **k)** të Kritereve të Përgjithshme për Kualifikim, Komisioni konstatoi, se operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK ka paraqitur dokumentet sipërcituara të rregullta dhe brenda afateve kohore (Listuar më sipër), në përmbushje të bazës ligjore referuese.

Për sa konstatuar më sipër, operatori ekonomik Optima Communication ShPK, ka paraqitur dokumentacion të saktë, të deklaruar me shtojcën 9 dhe faktuar me dokumentet provuese mbi përmbushje të kritereve dhe dokumentacioni provues i paraqitur rezulton në data përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Përsa më sipër operatori ekonomik përmbush kriteret e përgjithshme të kualifikimit të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “Inpress” ShPK për mosparaqitje nga operatori Optima Communication ShPK, dokumentacionin në përmbushje të kriterit 2.3.2, të “Kapacitetet teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, me pretendimin si vijon: [...] **Kriterin 2.3.2** “Operatori ekonomik duhet të paraqes **dëshmi për stafin e punonjësve si dhe listëpagesat sipas formatit E-Sig**, ku numri i punonjësve të siguar të jetë jo më i vogël se 5 (pesë) punonjës nga të cilët:

- -1 punonjës i diplomuar për designer grafik;

Për punonjësit e stafit teknik, operatori ekonomik duhet të paraqes: Kontratën individuale të punës/kontrata bashkëpunimi dhe diploma/certifikime nga kompani/institucione të certifikuar.”

Nuk disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.

Nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor të nevojshëm pranë AK-së.me anë të të cilit të provohet/vërtetohet disponimi i stafit.

III.3.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në SPE Dokumentet e Tenderit, Shtojcën 8, Kriterin 2.3.2 i modifikuar, si vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi dëshmi për stafin e punonjësve si dhe listpagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë jo më i vogël se 5 (pesë) punonjës, nga të cilët:

-1 punonjës i diplomuar për disegner grafik

Për punonjesit e stafit teknik, operatori ekonomik duhet të paraqesë: Kontratën individuale të punës/ kontrata bashkëpunimi, dhe diploma/certifikime nga kompani/institucione të certifikuara.

III.3.2. Komisioni nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertës depozituar në SPE si edhe dokumenteve provuese të përcjella nga Autoriteti kontraktor konstaton, se operatori ekonomik OPTIMA COMMUNICATION ShPK, në përmbushje të kriterit 2.3.2 ka përcjellë dokumentet si vijon:

1. Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i plotësuar, firmosur dhe vulosur nga Administratori. Deklarata Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) e plotësuar me 5 punonjessi vijon:

Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 5 Profili i punonjësve Dizenjator grafik, IT, Sipermarres, Punonjes zyre, Sherbime ndihmese, Specialist koordinimi, Koordinator eventesh, Specialist marketingu, etj

2. Deklaratë mbi Listapagesat të kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatime mbi të ardhurat për tre muaj, Nr. punonjesi.8.

3. Kontrate Individuale pune, me date 01.08.2025, midis palëve: Optima Communication ShPK dhe Z. T. B me profesion Disenjator, Bashkelidhur

3.1 Diplomë e shkollës mesme teknike, Diplome e Shkolles se Mesme Teknike-Elektrike "GJERGJ CANCO", në Drejtimin Mësimor Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, profili Multimedia, Niveli IV i KSHK, Certifikate matura shtetërore

3.2. Certifikate Kualifikimi Profesionale për lëndët dizajn e grafi, përpunim imazhe, realizim fotografi etj

4. Kontrate Individuale pune, me date 03.06.2021, midis palëve:Optima Communication ShPK dhe Z. Sh. G me profesion Disenjator Grafik, Bashkelidhur:

4.1 Diplomë e Akademisë së Arteve, Fakulteti i Arteve Figurative, lëshuar 09.07.2003, Specialist Grafikë.

5 Kontrate Individuale pune, me date 04.01.2021, midis palëve: Optima Communication ShPK dhe Z.E. R, ne pozicion Administratorit, Bashkelidhur:

5.1. Diplomë e Universitetit Politeknik Tiranë, Dega Elektronikë, titull Ing Elektronik dhe Drejtim Kompjuter. Leshuar 06.02.2006.

5.2. Certifikate Nr. 8812, nga Iris Education, me Licence nr.2575-01-2017, paketë profesionale për Graphic Design, date 24.03.2024.

6. Kontrate Individuale pune, me date 25.06.2024, midis palëve: Optima Communication ShPK dhe Znj.E. B, ne pozicion Specialist Koordinimi, analize dhe administrim te dhenanave ne rrjete.

7. Kontrate Individuale pune, me date 03.02.2025, midis palëve: Optima Communication ShPK dhe Z. B.R, ne pozicion Specialist Koordinimi, sherbime logjistike.

Dokumentacioni i firmosur dhe vulosur nga palët dhe i noterizuar.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar të përcjellë nga autoritetit kontraktor Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se referuar dokumentacionit ngarkuar në SPE të operatorit ekonomik "Optima Communication ShPK rezulton, se në përmbushje të kriterit 2.3.2, fillimisht me plotësimin e Shtojcës 9 në tërësi dhe në veçanti në pjesën III, Deklarata Për disponimin e punonjësve si edhe në vijim me dorëzimin e dokumenteve provuese të ofertës pranë AK-së, Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e ofertës konstatoi se: Operatori ekonomik "Optima Communication" ShPK në përmbushje të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, ka deklaruar punonjësit e kërkuar si edhe ka paraqitur dokumentacionin provues për personelin dhe për punonjësin e kërkuar në profilin disegner grafik duke rezultuar në përmbushje të kriterit kualifikues mbi personelin dhe specialistë të certifikuar, të kërkuar në kriterin 2.3.2. të shtojcës 8.

Për sa referuar më sipër nga verifikimet e dokumenteve të ofertës së operatorit ekonomik "Optima Communication" ShPK, listuar më sipër dokumentet provuese, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik përmbushur kriteret kualifikuese me dokumentacion të rregullt për sa i përket kërkesave në kriterin 2.3.2 të shtojcës 8 të DST.

Përsa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.4. Në lidhje me pretendimet për mospërmbushje të Kapacitetit teknik të kriterit: **Kriteri 2.3.4** *Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë dhe provojë se zotëron në pronësi ose me kontratë qiraje e cila duhet të përfshijë të gjithë afatin e realizimit të kontratës të paktën:*

▪**Dy makineri printimi/shtypi industrial.**

Njëra prej makinerive duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm prodhimi për materiale të buta (banners). Kjo makineri duhet të ketë kapacitet prodhimi dhe printimi minimumi 3,2 m gjerësi. [...]Ne shprehim bindjen tonë, që OE OPTIMA COMMUNICATION shpk. NUK disponon realisht Dy makineri printimi/shtypi industrial, ku njëra nga këto makineri duhet të ketë

kapacitet të mjaftueshëm prodhimi për materiale të buta (banners). Kjo makineri duhet të ketë kapacitet prodhimi dhe printimi minimumi 3,2 m gjerësi.

Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Optima Communication dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe teknik nuk ka paraqitur pranë AK, me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i makinerive/pajisjeve të kërkuar në DST, si dhe dokumentacioni plotësues i kërkuar në DST. Përsa i përket makinerisë/pajisjes së printimit/shtypit industrial, për materiale të buta (banners), ne kemi bindjen se me anë të dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur nga OE Optima Communication shpk. nuk provohet/vërtetohet kapaciteti i prodhimit dhe printimit me përmasat minimale prej 3,2 m gjerësi.

III.4.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në SPE Dokumentet e Tenderit, Shtojcën 8, Kriterin 2.3.4 i modifikuar, si vijon:

- **Kriteri 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë dhe provojë se zotëron në pronësi ose me kontratë qiraje e cila duhet të përfshijë të gjithë afatin e realizimit të kontratës të paktën:**

•Dy makineri printimi/shtypi industrial.

Njëra prej makinerive duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm prodhimi për materiale të buta (banners). Kjo makineri duhet të ketë kapacitet prodhimi dhe printimi minimumi 3,2 m gjerësi.

Kjo pikë duhet të vërtetohet nëpërmjet paraqitjes të faturave tatimore të blerjes sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku është blerë, deklaratën doganore.

Në rastin e marrjes me qira, të paraqitet i gjithë dokumentacioni i mësipërm, e cila duhet të përfshijë të gjithë afatin e realizimit të kontratës.

III.4.2. Referuar SPE-së operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e ofertës së tij, nga ku konstatohet, se operatori ekonomik Optima Communication ShPK, në përmbushje të kriterit 2.3.4 ka përcjellë dokumentet provuese si vijon:

1. Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i plotësuar, firmosur dhe vulosur nga Administratori, dhe Deklarata Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Makineri e mjete Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Ka listuar pajisjet në pronësi apo me kontratë qiraje, në përmbushje të kriterit 2.3.4

Dy makineri printimi/shtypi industrial. **Njëra prej makinerive** duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm prodhimi për materiale të buta (banners). Kjo makineri duhet të ketë kapacitet prodhimi dhe printimi minimumi **3,2 m gjerësi.**

Referuar Shtojcës 9, Komisioni nga shqyrtimi i dokumenteve provuese të përcjella nga AK rezulton se OE ka paraqitur dokumentet si vijon:

1: Kontratë qiraje, me datë 13.01.2026 lidhur midis palëve qiradhënës Subjekti Z. K. Z P.F dhe qiramarrës Optima Communication ShPK, me objekt: Mbi marrjen me qira Printer profesional dixhital ekologjik per prodhim banerash, marka SinoColor 3.2m, model SJ-1260C, shoqëruar me fature blerje te pajisjes nr. 3012-62-01, date 22 Nëntor 2018, dhe pjesë ndërrimi,

dokumente te tjera: Foto të pajisjes, Dokument Commercial invoice,(fatura e blerjes), dokument zhdoganimi, të Noterizuara.

2-Dokumentin e zhdoganimit **Pajisje profesionale printimi me bojra UV 3D**—shoqëruar me bojra dhe mjete mirëmbajtje, në pronësi me fature blerje nr. MT-22-SH-19599, date 16.09.2022, dhe dokument zhdoganimi me faturë e paguar, të Noterizuara.

3- Pajisje profesionale te ndryshme për materiale promocionale - në pronësi, 11 pajisje blerë me fature blerje nr 22An300, date 11 nentor 2022 dhe dokument zhdoganimi, 20.01.2023. të noterizuara.

Makineri libërlidhje, Makineri celofani/Plastifikimi, Makina prerese me thika, Makina Vijezi/performimi, Makina prerje per cepa rrumbullake, Makina per kopertina speciale te forta, Makine liberlidhje me biosjje dhe spirale, Makine liberlidhje speciale/qepje me tel, Makine per kloshe per varak te nxehte/te thate/reliev, Makine stampimi per material tekstil/porcel/te ngurta, Makine prerëse me forma.

III.4.3. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim dokumentacionin ngarkuar në SPE të operatorit ekonomik “Optima Communication ShPK në përmbushje të kriterit 2.3.4, fillimisht me plotësimin e Shtojcës 9, dhe në vijim me dorëzimin e dokumenteve provuese të ofertës pranë AK-se. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e ofertës Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se: Operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK në përmbushje të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka deklaruar Mjetet/pajisjet e kërkuara si edhe ka paraqitur dokumentacionin provues për mjetet e kërkuar •Dy makineri printimi/shtypi industrial, Njëra prej makinerive duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm prodhimi për materiale të buta (banners).dhe printimi minimumi 3,2 m gjerësi. **Listuar dokumentet më sipër të noteriazuara në përmbushje të kriterit 2.3.4. të shtojcës 8.**

Për sa referuar më sipër nga verifikimet e dokumenteve të ofertës së operatorit ekonomik “Optima Communication” ShPK, listuar më sipër dokumentet provuese, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ka përmbushur kriteret kualifikuese për sa i përket: kriterit 2.3.4 të shtojcës 8 të DST.

Përsa më sipër konstatuar pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.5. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga “Inpress” ShPK mbi mospërmbushje të specifikimeve teknike për të gjithë artikujt mostra të paraqitura nga operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK, Referuar pretendime për mosplotësim të specifikimeve teknike për mostrat kërkuar me kriterin 2.3.6. të DST-së si vijon:

Në pikën 2.3.6 “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST përcaktohet se: “Operatori ofertues, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostrat fizike për artikujt **1,5,6,9,17**, sipas shtojca 6 të specifikimeve teknike, pa logo të postës dhe të papersonalizuara. (Shënim) Mostrat fizike do të vlerësohen të rregullta me ose pa logo të personalizuar ose të papersonalizuara.”

Ak ka kërkuar specifikimet teknike si vijon për mostrat objekt ankimi:

1. Stilolaps me logo

Stilolaps me ngjyrë të bardhë dhe të zezë, branduar me logon e Posta Shqiptare Sh.a, materiali pleksiglas (ose ekuivalente), me **përmasa 14.2 cm x 1 cm (+/- 5%) hapësirë stampimi 5 cm x 0.8cm (+/- 5%)** dhe bojë shkrimi blu. Logo me ngjyrë gold dhe blu U.V.

Me printim dhe llakim parcial (ose ekuivalente) nga 2 anët.

OE pretendon: Mostra 1. Stilolaps me logo NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: Përmasave të Kutisë të dorëzuar - 14.2 cm x 1 cm (Marzhi i gabimit të përmasave 5%) Hapësirës së stampimit 5 cm x 0.8cm (+/- 5%); Printimit dhe llakimit parcial (ose ekuivalente) nga 2 anët. kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës Stilolaps me logo të dorëzuar nga OE OPTIMA COMMUNICATION shpk. për verifikimin e përpuethshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6, të DST [...].

5. Çantë e madhe kartoni;

Çantë e madhe kartoni, mat, materiali karton, në ngjyrë të zezë dhe blu, me doreza (lidhëse sintetik) në ngjyrë të zezë, përmasat: 35cm x 30cm x 10cm (+/- 5%) , e branduar me logon e Postës Shqiptare dhe slogani i Posta Shqiptare Sh.A, shkrimi ngjyrë varak i verdhë.

OE pretendon: Mostra 5 Çantë e madhe kartoni NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: Përmasave të cantës - 35cm x 30cm x 10cm (+/- 5%) Materialit karton; Ngjyrës së dorezës (lidhëse sintetik) në ngjyrë të zezë Ngjyrës së zezë dhe blu. Siç përcaktohet në shtojcën 6,Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës..[...]

6. Çantë beze

Çantë beze - Posta Shqiptare (ngjyrë bezhë, edicion praktik & ekologjik). Çantë tekstili me përdorim të përditshëm ose institucional (ose ekuivalent). Branding i thjeshtë, funksional dhe i dukshëm për identitetin zyrtar të Postës Shqiptare. Përmasat standard: Lartësi: 38 cm ,

Gjerësi: 34 cm, Thellësi (fund i palosur): 8–10 cm (+/- 5%). Gjatësia e dorezave: 60 cm (+/- 5%) për ta mbajtur lehtësisht në sup. Ngjyra e çantës: Bezhë natyrale. Logo & slogan:printim me ngjyrë blu.

OE pretendon: Mostra 6, Çantë beze NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: Përmasave të cantës së dorëzuar - Lartësi: 38 cm, Gjerësi: 34 cm,

Thellësi (fund i palosur): 8 10 cm (+/- 5%). Gjatësia e dorezave: 60 cm (+/- 5%) Ngjyrës së cantës së dorëzuar - Bezhë natyrale. Siç përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike.

Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës

9. Fletëpalosje (shërbime, histori, inovacion)

Fletëpalosje me përmasa: A4 me palosje sa 1/3 e A4, 2 anë print, 4 color, letra 170 gr. (imazhi i printimit sipas dizainit pas miratimit) tematika dhe teksti që do përmbajë fletpalosja do miratohen nga Posta Shqiptare, branduar me logon e Postës Shqiptare.

OE pretendon: *Mostra 9, Fletëpalosje (shërbime, histori, inovacion) NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: Përmasave të fletëpalosjes së dorëzuar - A4 me palosje sa 1/3 e A4 Peshës së letrës së fletëpalosjes të dorëzuar - letra 170 gr; Siç përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet TeknikePër këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës [...]*

17. Korniza pecikllaz për vendosjen e posterave në formatin 50x70

Kornizë pecikllaz për postera – format 50x70 cm. Përmasa e jashtme e kornizës rreth 54 x 74 cm, gjerësia e profilit të pecikllazit 2.5 cm ose 3.2 cm (standarde). Pllaka e pasme polistiren i fortë. Pjesa e përparme fletë PVC transparente anti-refleks (për mbrojtje të posterit).Mekanizmi i hapjes do të jetë në pjesën e pasme të kornizës me kapse metalike në 4 anët që lejojnë vendosjen dhe zëvendësimin e lehtë të posterit.

OE pretendon: *Mostra 17, NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: Përmasat e Kornizës së dorëzuar - format 50x70 cm. Përmasa e jashtme e kornizës rreth 54 x 74 cm, gjerësia e profilit të pecikllazit 2.5 cm ose 3.2 cm (standarde); Materialit të Kornizës së dorëzuar - Pllaka e pasme polistiren i fortë. Pjesa e përparme fletë PVC transparente anti-refleks (për mbrojtje të posterit) Siç përcaktohet në shtojcën 6, Specifikimet Teknike, të DST: të gjitha specifikimet teknike të kërkuara do të duhet të jenë në përputhje të plotë.... Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës [...]*

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit të afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës”, ku ndër të tjera janë faktet dhe provat në të cilat bazohet ankesa.”

III.5.1 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në të drejtën e operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashetrojnë pretendime a-priori si në rastin konkret mbi të gjitha mostrat dhe përmasat e tyre

duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku i mbështet pretendimet e tij, si i ka konstatuar parregullsitë e tyre.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij, se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “onus probandi incumbit actori” se barra e provës bie mbi ankuesin.

Sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimin e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik edhe pse operatori dikton testimin e te gjitha mostrave për të gjitha specifikimet mbi përmasat.

III.5.2. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson dallimin e qartë në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, *nuk jemi në rastin konkret* pasi ankimuesi nuk është i skualifikuar, nga njëra anë dhe pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar efencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në kraht të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Një pretendim në total, NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, sa i përket: ...për të gjitha mostrat dhe të gjitha përmasat, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit të kualifikuar, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një quasi gjykatë dhe refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një pretendim i cili nuk mbështetet në asnjë argument dhe nuk identifikon në mënyrë të qartë se cili prej mostrave të dorëzuara nuk përmbush kërkesat/specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, por vetëm mbi

pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme dhe të pafaktuara por mbi dyshime/hamendësime mbi të gjitha specifikimet teknik.

Sa më lart pretendimet e operatori ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-62627-09-25-2025, me objekt “Realizimi dhe prodhimi i materialeve promocionale për promovimin e markës, shërbimeve postare - financiare dhe produkte filatelike”. me fond limit 5.000.000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapa të mëtejshëm procedurën e prokurimit sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

